



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:283690

Datë: 11.11.2024

Numri i dokumentit: 06431989

C-IV-14-6206

Ankuesi

A H ish punëtor i NSH IGK “Ballkan”, përfaqësuar nga **A H** nga Suhareka.
*Përfaqësuar nga **R G avokat, Suharekë.***

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 08 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa / kërkesa për kompensim të të ardhurave të garantuara minimale për periudhën 08 gusht 1990 – 01 korrik 1999, në shumë prej 5,327.56 € nga NSH “IGK Ballkan” Suharekë (*në likuidim*) si e pabazuar.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 23 shtator 2014, përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit (nëpërmjet postës) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një padi / kërkesë për kompensim të të ardhurave të garantuara minimale për periudhën 08 gusht 1990 – 01 korrik 1999, në shumë prej 5,327.56 € nga NSH “IGK Ballkan” Suharekë (*në likuidim*). Përfaqësuesi i autorizuar theksoi se me vendimin e këshillit të punëtorëve nr.287/1 të datës 20 gusht 2001, të gjithë punëtorëve të kësaj ndërmarrje të cilët ishin larguar nga puna kolektivisht me vendimin e organeve të dhunshme serbe të cilët në mënyrë të kundërligjshme u vendosën në NSH-IGK “Ballkan” në Suharekë sipas vendimit të Kuvendit të Serbisë nr.43/90 të datës 08 gusht 1990, i njihet e drejta nga marrëdhënia e punës si dhe të ardhurat e garantuara minimale për secilin punëtor (nga 5,327.56 €) për periudhën e largimit nga data 08 gusht 1990 deri më 01 korrik 1999 si dhe njohjen e stazhit të punës për periudhën e lartshënuar sipas ligjeve në fuqi. NSH-ja nuk e ka ekzekutuar vendimin për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Gjykata Komunale në Suharekë, pas shqyrtimit të padisë së punëtorëve të

NSH-së, nxjerr aktgjykimin C.nr.176/05 të datës 24 qershor 2006 me të cilin aprovon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe e obligon të paditurën NSH-në që të gjithë punëtorëve nga numri rendor 1 deri 1396 në mënyrë lineare t’ia kompensoj të ardhurat e garantuara minimale për periudhën 08 gusht 1990 deri më 01 korrik 1999 secilit nga 5,327.56 € në shumë të përgjithshme pa kamatë si dhe stazhin e punës për të njëjtën periudhë. Përfaqësuesi i autorizuar më tej shton se AKP me vendim të veçantë, të gjithë punëtorëve të përfshirë me aktgjykimin C.nr.176/05 ia ka njohur të drejtën për të ardhura të garantuara në shumë prej 5,327.56 €. Ish punëtorët të cilët nuk kanë qenë në listën si paditës në padinë e datës 23 qershor 2005, ende nuk e kanë fituar këtë të drejtë. Prandaj, problemi qëndron në faktin se në padinë e datës 23 qershor 2005 nuk janë përfshirë disa punëtorë të NSH-së dhe atë pa fajin e tyre. A H si ish punëtor i përfaqësuar tani nga A H ka qenë me të njëjtin status punëtorë sikur edhe punëtorët si paditës në padinë e datës 23 qershor 2005. Kanë qenë në marrëdhënie të rregullt pune dhe i kanë marr vendimet për kompensimin e të ardhurave të garantuara në shumën prej 5,327.56 €. Ankuesi nuk e din fare se për çfarë arsye nuk është përfshirë në padinë e datës 23 qershor 2005 dhe për këtë arsye AKP nuk ia ka njohur të drejtën për stazh të punës dhe për të ardhurat e garantuara sikur ish punëtorëve të tjerë të përfshirë në padi. Përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit i propozon gjykatës që të aprovoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe të obligohen të paditurit gjegjësisht AKP që nga fondi i krijuar me rastin e privatizimit dhe likuidimit të NSH-së, A H i përfaqësuar nga A H t’ia kompensoj të ardhurat e garantuara minimale dhe atë nga 5,327.56 € sipas vendimit të paditurës së dytë si dhe t’i njeh të drejtën e stazhit të punës për periudhën nga data 08 gusht 1990 deri më 01 korrik 1999. Në mbështetje të saj ka bashkangjitur prokurën për përfaqësim dhe dëshmitë në kopje si: Parashtrësën – kërkesën për lirim nga shpenzimet, Njoftimin lidhur me ngritjen e padisë dhe Kërkesën për pagesën e të ardhurave që të dyja të datës 16 qershor 2014, Vendimin mbi njohjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës për periudhën 8 gusht 1990 – 1 korrik 1999, lëshuar nga Këshilli i Punëtorëve të NSH-së nr. 872, datë 20 gusht 2001, librezën e punës për ish-punëtorin A H dhe letërnjoftimin e ankueses.

Me 08 gusht 2024, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtjen e saj në të cilën thekson se Ndërmarrja Shoqërore “IGK Ballkan” ka hyr në procedurë të likuidimit më 06 mars 2008. Në lidhje me rastin e A H është informuar se nuk ka parashtruar asnjë kërkesë për kompensimin e të ardhurave personale si rezultat i procesit të privatizimit të NSH-së. Andaj duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, neni 35.3 i Shtojcës, kërkesa e parashtruesit nuk do të konsiderohet për procedim të mëtutjeshëm. AL mund në diskrecion të plotë të pranoj kërkesën e dorëzuar pas afatit për dorëzimin e kërkesave, nëse kërkesa është dorëzuar jo më vonë se 30 ditë pas afatit për dorëzimin e kërkesave me arsye bindëse për dorëzimin e vonuar. Andaj, AL thekson edhe njëherë se parashtruesi i kërkesës ka humbur afatin për paraqitjen e kërkesës dhe kjo duhet të refuzohet mbi bazën e nenit 35.3 të Ligjit për AKP. Si përfundim, e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086. Në mbështetje të mbrojtjes së saj e paditura ka bashkëngjitur vendimin për përbërjen / emërimin e anëtarëve të AL datë 1 nëntor 2022.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga pohimet e palëve dhe shkresat e lëndës gjykata gjen se ish punëtori A H i përfaqësuar nga ankuesja me ankesën / kërkesën e saj kërkon kompensim të të ardhurave të garantuara minimale për periudhën 08 gusht 1990 – 01 korrik 1999, në shumë prej 5,327.56 € nga NSH “IGK Ballkan” Suharekë (*në likuidim*), mbi bazën e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.176/05, datë 24 qershor 2006, të cilën e paditura konteston pasi ankuesja nuk ka dorëzuar asnjë kërkesë kreditore brenda afatit për dorëzimin e kërkesave në likuidim.

Gjykata pasi ka shqyrtuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës dhe gjen se të vetmet dëshmi relevante të dorëzuara nga ankuesja në këtë rast janë: Vendimin mbi njohjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës për A H për periudhën 8 gusht 1990 – 1 korrik 1999, lëshuar nga Këshilli i Punëtorëve të NSH-së nr. 872, datë 20 gusht 2001 dhe librezat e punës e ish punëtorit A H me nr. regjistri 2423. Nga librezat e punës nuk ka të dhëna se i njëjti ka punuar si punëtor i NSH. Megjithatë, vendimi i lartcekur për kërkesën e saj për paga të papaguara i referohet periudhës kohore 08 gusht 1990 – 01 korrik 1999. Bazuar në pretendimet e saj dhe aktgjykimin mbi bazën e të cilit kërkon kompensimin për paga të papaguara objekt kontesti, e njëjta e pranon se A H nuk ka qenë i përfshirë në padinë e datës 23 qershor 2005 me arsyetim se pa fajin e tyre ai dhe disa punëtorë të tjerë të NSH-së nuk janë përfshirë, në atë rast. Duke u nisur nga ky fakt i pakontestueshëm, gjykata konsideron se aktgjykimi C.nr.176/05 datë 24 qershor 2006 lëshuar nga Gjykata Komunale në Suharekë me të cilin është aprovuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve dhe është obliguar e paditura NSH-në që të gjithë punëtorëve nga numri rendor 1 deri

1396 në mënyrë lineare t'ia kompensoj të ardhurat e garantuara minimale për periudhën 08 gusht 1990 deri më 01 korrik 1999 secilit nga 5,327.56 € në shumë të përgjithshme, nuk mund të shërbej si bazë për aprovimin e kërkesës së ankueses në këtë rast, pasi një kërkesë e tillë nuk ishte objekt shqyrtimi sipas padisë në fjalë nga Gjykata Komunale në Suharekë dhe si i tillë ky aktgjykim nuk përfshin emrin e tij përkatësisht nuk vërteton drejtpërdrejt pretendimet e saj për paga të papaguara për A H për periudhën kohore objekt kontesti. Për më tepër, siç është konstatuar nga pohimet e palëve dhe shkresat e lëndës, ankuesja nuk kishte parashtruar fare kërkesë kreditore në procedurën e likuidimit tek AL, në lidhje me kërkesën për paga të papaguara për periudhën kohore objekt kontesti mbi bazën e aktgjykimit në fjalë.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj për kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të ankueses në lidhje me kërkesën e saj për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç refuzimit të ankesës në lidhje me kërkesën e saj për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti, prandaj si të tilla edhe refuzohen.

Meqenëse, NSH ka hyr në procedurë të likuidimit me 06 mars 2008 dhe tanimë kanë kaluar të gjitha afatet ligjore sa i përket shqyrtimit eventual të kërkesave kreditore në procedurat përkatëse të likuidimit tek AL, gjykata konsideron se procedura gjyqësore në këtë rast nuk mund të pezullohet, andaj vendosi vazhdimin e saj.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Gjykata ka shqyrtuar kërkesën e ankueses për lirim nga shpenzimet dhe për shkak të gjendjes së saj ekonomike, ka vendosur që të njëjtën ta aprovoj, andaj si rrjedhojë ankuesja nuk do të ngarkohet me taksë gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar